


# KISCOMS

INTERNATIONAL CONGRESS OF MEDICAL SCIENCES

6-7 May, 2017  
Swiss Diamond Hotel  
Prishtina, Republic of Kosovo

## ABSTRACT BOOK

FINAL PROGRAM



**Hyrje:** Cilësia e ujërave sipërfaqësore ka rëndësi në aspektin shëndetësorë publik si për ujitje nga bujqit, ashtu edhe për shfrytëzimin e ujit për sport dhe rekreim. Mostrat e ujit për analizë fiziko-kimike dhe bakteriologjike merren një herë në muaj nga 12 pika matëse në Shkup.

**Qëllimi:** Përmirësimi i cilësisë së ujit në lumenjtë Vardar, Treska, Lepencë dhe Pçinja në raport me josigurinë e tyre sipas parametrave biologjik.

**Materiali dhe metoda:** Të dhënat janë të fituara nga raporti vjetor për gjendjen sanitaro-higjienike të ujërave siperfaqësorë nga ana e Qendrës për Shëndet Publik në Shkup, për vitin 2015. Në punim janë të përdorura metoda mikrobiologjike dhe fiziko-kimike si dhe përpunimi përfundimtar statistikor.

**Rezultate:** Analizat e mostrave të marrura nga ujërat sipërfaqësore tregojnë pjesëmarrje procentuale të disa parametrave bakteriologjik: prej gjithsej 66 mostra uji të marrura, 94,29% janë jo të sigurta në aspektin bakteriologjik, prej tyre 69,70% i takojnë numrit të mundshëm të bakterieve koliforme nga gjithsej 46 mostra të marrura të ujit, 10,61% E.coli prej gjithsej 7 mostra uji, 25,57% Enterococcus prej gjithsej 17 mostra uji, 7,57% Proteus spp. prej gjithsej 5 mostra uji, 12,12% Pseudomonas spp. prej gjithsej 8 mostra uji dhe 6,06% numri i përgjithshëm i bakterieve aerobe mezofile prej gjithsej 4 mostra uji. Në bazë të rezultateve të fituara për përcjelljen e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë, 70% të lumenjëve i takojnë klasës së IV dhe 30% klasës së V.

**Përfundim:** Lumenjtë janë të ndotur si pasojë e ndikimit antropogen, respektivisht hudhjes së pa trajtuar të ujërave të zëza komunale prej vendeve të banuara urbane. Patjetër është e nevojshme të përmirësohet cilësia e ujërave sipërfaqësorë të lumenjëve, për shkak të rrezikut potencial të shfrytëzimit të ujërave të kontaminuara për ujitje dhe për futjen e rrezikut në zinxhirin e ushqimit për kafshët dhe njeriun.

**Fjalë kyçe:** Lumenjtë, ujëra sipërfaqësorë, siguria bakteriologjike, kontaminimi, klasa.

#### **“Monitoring the quality of surface waters in Skopje from health aspect”**

P. Simjanoski<sup>1</sup>, V. Dobrosavljevik<sup>1</sup>, Sh. Musa<sup>1</sup>, R. Pejcinovska<sup>2</sup>, M. Gjetaj – Jakovski<sup>1</sup>, Lj. Kostadinovski<sup>1</sup> / <sup>1</sup>Center for Public Health – Skopje, R. Macedonia

**Introduction:** The quality of surface waters is of great importance in terms of public health aspect, both for irrigation of agriculture and water sports & recreation. Water samples for physic-chemical and bacteriological analysis are taken once a month from 12 measuring points in Skopje.

**Goal:** Improving water quality in the rivers Vardar, Treska, Lepenec and Pchinja regarding their unsafety in bacteriological parameters.

**Materials and methods:** The data are derived from the Annual Report of the hygienic-sanitary condition of surface water from CPH Skopje for year 2015. This paper uses microbiological and physic-chemical methods, as well as statistical processing of the data.

**Results:** Analyses of taken samples from surface waters indicate the percentage of certain bacteriological parameters taken from a total of 66 samples of water, 94,29% are bacteriologically contaminated and 69,70% are probable number of coliforms from total of 46 water samples, 10,61% E. Coli from total 7 samples of water, 25,75% Enterococcus from total of 17 samples of water, 7,57% Proteus spp from of 5 water samples, 12,12% Pseudomonas spp from total of 8 samples of water, and 6,06% total number of aerobic mesophilic bacteria from a total of 4 samples of water. According to the results of monitoring the quality of surface water, 70% of rivers account of class IV and 30% of class V.

**Conclusions:** Rivers are polluted due to human influence, by discharging untreated municipal wastewater from urban settlements. It is necessary to improve the quality of surface water from rivers, due to the potential danger of using polluted water for irrigation and entry of polluted water in the food chain of cattle and humans.

**Key words:** River, Surface water, Bacteriological unsafety, Pollution, Classes.